



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:130861

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05484542

PPP.nr.213/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si përbarimore me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, ne çështjen juridike te kreditorit KRM Uniteti SH.A me seli në Mitrovicë, kundër debitorit Z.J Rr. A.D nr.117(K) K-M, lidhur me pagesën e borxhit ne shumë prej 287.10 €, gjykata, duke vendosur sipas prapësimit të parashtruar nga debitori me dt. 24.12.2018 kundër urdhrorit mbi lejimin e përbarimit, gjykata jashtë seancës me datën 21.03.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET prapësimi i debitorit Z.J Rr. A.D nr.117(K) K-M, ushtruar kundër urdhrorit mbi lejimin e përbarimit P.nr.1371/2018 të dt. 13.12.2018, si dhe **SHFUQIZOHET** urdhri mbi lejimin e përbarimit P.nr.1371/2018 të dt. 13.12.2018, dhe të gjitha veprimet e ndërmarra përbarimore abrogohen.

A r s y e t i m

Kreditori, KRM Uniteti SH.A me seli në Mitrovicë, ka parashtruar propozim për lejimin e përbarimit kundër debitorit Z.J Rr. A.D nr.117(K) K-M, lidhur me pagesën e borxhit ne emër te sherbetimeve te kryera lidhur me pastrimin e mbeturinave për periudhën kohore 28.02.2006 e gjer me 31.12.2016, ne shumë totale prej 287.10 €, me kamate prej 8% vjetore, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, të gjitha në afat 7 ditore në të kundërtën të behet bllokimi i llogarive bankare, regjistrimi, vlerësimi, sekuestrimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, e mjetet e mbledhura te derdhen ne llogari te kreditorit, te gjitha këto te specifikuar ne propozimin për përbarim te dt:13.12.2018.

Organi përbarues me Urdhrin P.nr.1371/2018 të dt. 13.12.2018, e ka lejuar përbarimin sipas propozimit te kreditorit.

Debitori Z.J Rr. A.D nr.117(K) K-M, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim me shkrim, duke kundërshtuar propozimin për përbarim si të pa bazuar duke kërkuar qe te aprovohet prapësimi dhe te anulohet urdhri përbarimor me arsyetimin se duke u bazuar edhe ne kohen e gjatë qe ka kaluar ky borxh sipas dispozitave ligjore te nenit 360 te LMD-së është vjetërsuar dhe kërkon nga gjykata qe ta liroj nga ky borxh

Kreditori është njoftuar me prapsim, mirëpo nuk ka paraqitur përgjigje në prapsim.

Gjykata Themelore Mitrovicë, si përmbartimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se të njëjtit është i bazuar. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit tregojnë shkaqe sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, sipas të cilave do të pengohej përmbartimi i lejuar nga përmbartuesi privat.

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe pretendimeve të debitorit në prapësimin e parashtruar, lidhur me atë që të aprovohet prapësimi dhe të anulohet urdhri përmbartimor për shkak të parashkrimit, gjykata të njëjtat pretendime i aprovoj si të bazuara dhe atë duke u bazuar në nenin 360 par.1 të LMD-së, pasi që i tërë borxhi me të cilin ngarkohet debitori D.I Rr. T i P p/n Mitrovicë, për periudhën kohore 2006-2016, është borxh i parashkruar, konform nenit 360, par.1 nën par.1.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili nën flet për afatin një vjetar të parashkrimit e i cili parashih se “kërkesat për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”, e në rastin konkret borxhi të cilin e kërkon kreditori në bazë të ekstraktit të konsumatorit shihet se është deri me date 31.12.2016, ku debitori dhe kreditori kanë lidhur kontratë me dt. 09.06.2016 për pagesën e borxhit me këste, dhe që nga ajo datë ka nisur edhe të rrjedh afati i ri i parashkrimit konform nenit 373 të LMD-së, dhe që nga kjo datë për faturat e vitit 2016 ka filluar të rrjedh parashkrimi nga data 01.01.2017 dhe ka rritur parashkrimi me dt. 31.12.2017 duke u bazuar në par.2 të nenit 360 të LMD-së, kurse kreditori e ka paraqitur propozimin me dt. 13.12.2018 pas kalimit të afatit ligjor, andaj edhe rrjedhimisht gjykata e aprovoj prapësimin e debitorit dhe e shfuqizoj urdhrin përmbartimor si në dispozitiv të këtij aktvendimi për shkak të parashkrimit.

Ndërsa gjykata, pretendimet e kreditorit në përgjigjen në prapësim i refuzoj si të pa bazuara për faktin se të njëjtat pretendime nuk ishin të bazuara me fakte dhe prova si dhe nuk ishin të bazuara në dispozitat ligjore të LPP-së dhe LMD-së.

Gjykata konform nenit 17 të LPP-së, përshtatshmërisht aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, dhe konform dispozitave të nenit 3, 17, 29 par.1.2 dhe par.3, 69, 71 e 73 par. 3 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, lidhur me nenin 360 par.1 dhe 2, dhe 373 të LMD-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
PPP.nr.213/2019, dt: 21.03.2024

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankese, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa parashtrohet përmes kësaj gjykate.